

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7- 32

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë Albanian Financial Institution sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albanian Financial Institution sh.p.k** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare individuale. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijueshmërisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Teit Gjini
Auditues Ligjor

 MAZARS 29 qershor 2020

Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000 Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al | info@mazars.al

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata material	6	1,678,913	1,989,916
Aktivet afatgjata jomateriale	7	7,531,573	1,917,779
Totali i aktiveve afatgjata		9,210,486	3,907,695
Aktivet afatshkurtra			
Mjetet monetare në arkë e në bankë	8	30,382,196	11,698,507
Hua për klientët (neto)	9	664,476,048	477,399,109
Llogari të arkëtueshme nga tatimet	10	124,509,031	94,508,277
Llogari të arkëtueshme të tjera	11	4,913,600	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	12	1,060,488	1,223,698
Totali i aktiveve afatshkurtra		825,341,363	584,829,591
Totali i aktiveve		834,551,849	588,737,286
KAPITALI			
Kapitali aksionar/themeltar		266,260,000	266,260,000
Fitime të mbartura		(10,974,335)	(15,075,769)
Fitimi i ushtrimit		18,718,431	4,101,434
Totali i kapitalit	13	274,004,096	255,285,665
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	14	244,247,654	120,078,865
Totali i detyrimeve afatgjata		244,247,654	120,078,865
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	15	116,738,769	57,499,772
Llogari të pagueshme tregtare	16	3,785,748	7,087,848
Paradhenie të marra	17	11,831,337	18,239,998
Detyrime tatimore	18	527,802	497,992
Tatimi mbi fitimin		1,432,074	-
Detyrime të tjera	19	24,610,876	72,588
Detyrime ndaj paleve të lidhura	20	157,373,493	129,974,558
Totali i detyrimeve afatshkurtra		316,300,099	213,372,756
Totali i detyrimeve		560,547,753	333,451,621
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		834,551,849	588,737,286

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	55,472,736	39,604,335
Të ardhura të tjera	22	6,892,423	6,442,002
Shpenzime për interesa	23	(12,122,633)	(7,353,186)
Total të ardhura		50,242,526	38,693,151
Shpenzime për provizione	24	(3,368,919)	(1,798,533)
Shpenzime për paga	25	(15,177,108)	(14,441,019)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	26	(311,003)	(393,188)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	27	(8,221,582)	(5,055,321)
Total shpenzime		(27,078,612)	(21,688,061)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	28	(2,320,177)	(12,512,578)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	29	(663,232)	(391,078)
Fitimi/humbja para tatimit		20,180,505	4,101,434
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(1,462,074)	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	30	(1,462,074)	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		18,718,431	4,101,434
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		18,718,431	4,101,434

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Financial Institution sh.p.k

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Pozicioni financiar më 1 janar 2018	Kapitali i nënshkruar	Humbje të akumuluar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
	101,240,000	(2,446,938)	(12,628,831)	86,164,231
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	165,020,000	-	4,101,434	4,101,434
Transferim në fitime të mbartura	-	(12,628,831)	12,628,831	165,020,000
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	266,260,000	(15,075,769)	4,101,434	255,285,665
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				
Transferim në fitime të mbartura	-	4,101,434	(4,101,434)	18,718,431
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	266,260,000	(10,974,335)	18,718,431	274,004,096

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më 19.05. 2020 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Znj. Elona Telha
Administrator

Znj. Estela Gjyzari
Hartuese e Pasqyrave Financiare


Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	20,180,505	4,101,434
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	311,003	393,188
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues		
Rënie/(rritje) në hua te dhena	(187,076,939)	(33,640,110)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(34,944,354)	(23,269,969)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	48,664,933	(122,854,854)
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(6,408,661)	18,239,998
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	163,210	(1,147,837)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(159,110,303)	(158,178,150)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(5,613,794)	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(5,613,794)	-
Aktivitetet financuese		
Ripagim i huave afatgjata	183,407,786	(27,833,264)
Te hyrat/(ripagim) neto ne hua afatshkurtra	-	10,770,869
Emetim kapitali	-	165,020,000
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	183,407,786	147,957,605
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	18,683,689	(10,220,545)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	11,698,507	21,919,052
Mjetet monetare në fund të periudhës	8 30,382,196	11,698,507

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i Përgjithshëm

Albanian Financial Institution sh.p.k (më poshtë "Shoqëria") është një shoqëri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 27.11.2015 dhe është pajisur me NIPT L52327028M.

Objekti i Shoqërisë është ushtrimi i aktivitetit të faktoringut si dhe aktiviteteve të tjera financiare jo-bankare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria ofron të gjitha format e kredisë, faktoringun, qira financiare, ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve, shërbime këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e shoqërisë.

Shoqëria është licensuar në bazë të ligjit nr 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe rregullores "Për Licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo-banka", miratuar me vendim nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me licencë nr 07/1.

Kapitali aksionar i Shoqërisë është 266,260,000 lekë dhe zotërohet nga aksionerët:

-Besnik Leskaj i cili zotëron 80% të aksioneve;

-Redjan Basha i cili zotëron 20% të aksioneve;

Administrator i Shoqërisë është Znj. Elona Telha.

Selia e Shoqërisë është Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati përballë RTSH-së, Kati I, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë.

Nr i punonjësve në 31 dhjetor 2019 ka qenë 7 punonjës (31 dhjetor 2018: 8 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të pa parashikuar.

Referohuni Shënimit 5 për pasiguri në lidhje me ngjarjet dhe kushte që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të për të vazhduar në bazë të parimit të vijimësisë.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përkrahur më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"

Politikë e aplikueshme që nga 1 janari 2019.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"

Politikë e aplikueshme që nga 1 janari 2019

SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qira financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Shoqëria ka analizuar qiratë dhe i ka përjashtuar ato nga klasifikimi si qira financiare sepse janë qira afatshkurtra për një periudhë më të vogël se 12 muaj.

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2019, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures – Amendimet e SNK
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2015- 2017
- Plani i ndryshimit ose zgjedhjes – Amendimet në SNK 19
- Interpretimi 23 Pasiguria mbi trajtimin e tatimit të të ardhurave
- KIRFN 23 Pasiguria mbi pozicionet e tatimit mbi të ardhurat (efektive nga 1 janar 2019)
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015 -2017) (detyrimisht efektive për periudhën që fillon më 1 janar 2019
- Amendimet në SNRF 9 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative (efektive nga 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 19 "Planet e ndryshimit, mbylljes ose zgjedhjes"(detyrimisht efektive për periudhat nga ose pas 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 28 "Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures" (detyrimisht efektive për periudhat më ose pas 1 janar 2019)
- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" (detyrimisht efektive për periudhat më ose pas 1 janar 2021)

3.2 Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Bordi Nderkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standard dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standard dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2019:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve – efektive për periudhat pas 1 janar 2021
- Amendimet e SNK 1 dhe SNK 8 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Amendimet e SNRF 3 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar – efektive për periudhat pas 1 janar 2020

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet monetare të emtuara në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhë funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit. Zërat jo monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike nuk konvertohen.

Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kurset zyrtar të Bankës së Shqipërisë për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 ishin si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

4.2 Instrumenta financiarë

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit. Fillimisht Shoqëria i regjistron aktivitet dhe detyrimet financiare me vlerën e drejtë. Matja e mëvonshme për secilin instrument financiar është e detajuar në shënimet e mëposhtme.

Shoqëria ç' regjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhën e parasë nga aktivi skadojnë ose në qoftë se transferon të drejtat për të arkëtuar flukset kontraktuale të parasë të aktivitet financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitet financiar transferohen. Çdo interes në aktivitet financiare të transferuara që është krijuar apo përfituar prej Shoqërisë njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtues të institucionit.

Matja e kostos së amortizimit

Kostoja e amortizuar e një aktivitet ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivitet ose detyrimi njihet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë dhe paradhëniet për klientët janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe institucioni nuk ka për qëllim t'i shesë në periudha afatshkurtra. Huatë dhe paradhëniet klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme.

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive. Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së kostos së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat maturimi me më pak se tre muaj.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë matur me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Në çdo datë raportimi, Institucioni vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që aktivet financiare të cilat nuk janë mbajtur me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave janë të zhvlerësuar. Aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohet më vete kur faktet objektive ose kriteret e gjykimit tregojnë që një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit (aktiveve), dhe që kjo ngjarje humbjeje ka një impakt në flukset e ardhshme të parasë nga ky mjet që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Faktet objektive që aktivet janë zhvlerësuar mund të përfshijnë vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit, mospërbushje e detyrimeve ose shkelje e detyrimeve nga huamarrësi në lidhje me pagesat e interesit dhe të principalit, ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Institucioni për shkak të vështirësive financiare të klientit dhe me kushte që Institucioni nuk mund të shqyrtojë ndryshe, tregues që një huamarrës ose emetues do të falimentojë, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të njohura në nivel kombëtar ose lokal në lidhje me një grup aktivesh si ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së huamarrësve dhe ose emetuesve në grup, ose kushtet ekonomike të cilat lidhen me mospërbushjen e detyrimeve në grup, apo një rënie e matshme të parashikimit të rrjedhës së parave që pritet nga një grup i aktiveve financiare që nga momenti i njohjes fillestare të këtyre aktiveve. Institucioni merr në konsideratë treguesit për zhvlerësimin e huave dhe paradhënieve dhe të investimeve në letra me vlerë të vendosjes në nivelin e një aktivi të vetëm dhe kolektivisht. Të gjitha aktivet financiare të rëndësishme, huatë, paradhëniet dhe investimet në letra me vlerë të vendosjes, vlerësohen veçmas për zhvlerësime specifike. Aktivet financiare të cilat nuk rezultojnë të zhvlerësuar në veçanti, vlerësohen të gjitha së bashku për ndonjë zhvlerësim që mund t'i ketë ndodhur, duke grupuar së bashku aktivet financiare huatë dhe paradhëniet, të cilat paraqesin karakteristika të ngjashme të riskut.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të cilat janë matur me kosto të amortizuar llogariten në bazë të diferencës së shumës së mbartur të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të përlllogaritur të mjeteve monetare të skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen tek pasqyra e të ardhurave dhe paraqiten në llogarinë e fondit të huave dhe paradhënieve. Kur një ngjarje e mëvonshme influencën në zvogëlimin e shumës së humbjes nga zhvlerësimi i aktivit, humbja kthehet tek pasqyra e të ardhurave. Fluksi i parashikuar i mjeteve monetare nga huatë dhe paradhëniet paraqiten me vlerën e skontuar të kolateralit. Të ardhurat nga kolaterali vlerësohen pas zbritjeve nga vlera e tregut dhe përcaktimit të planit kohor të rikuperimit, në varësi të llojit të kolateralit.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aty ku është e mundur Institucioni bën ristrukturimin/rinegociimin e huave sesa marrjen në zotërim të kolateralit. Kjo përfshin zgjatjen e afatit të pagesave për kthimin e huasë dhe marrëveshjen për kushte të reja kredie. Nëse kushtet dhe afatet e një aktivi financiar ri-negociohen ose modifikohen ose një aktiv financiar ekzistues zëvendësohet me një aktiv të ri për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë vlerësohet për zhvlerësim më vete. Drejtimi në mënyrë të vazhdueshme rishikon kreditë e rinegociuara për të garantuar përmbushjen e të gjitha kriterëve dhe kryerjen e pagesave në të ardhmen.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari për fondin e huave dhe paradhënëve si dhe të investimeve në letra me vlerë të vendosjes, nëse ka. Nëse njohja e një ngjarje që ka ndodhur pas zhvlerësimit zvogëlon humbjen nga zhvlerësimi, zvogëlimi i humbjes nga zhvlerësimi rimerret përmes pasqyrës së të ardhurave.

4.3 Interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit me përjashtim të arkëtueshmëve afatshkurtra ku njohja e interesit do të jetë imateriale. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimit të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet me njohjen fillestare të aktivit dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, institucioni vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhme duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo humbjet nga kredia në të ardhmen.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat që paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë:

- Interesat për aktivin dhe detyrimin financiar të cilat maten me koston e amortizuar llogariten me anë të metodës së normës efektive të interesit; dhe
- Interesat për letrat me vlerë të vendosjes të cilat llogariten me anë të metodës së normës efektive të interesit.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat dhe shpenzimet për komisionet njihen në momentin që është realizuar shërbimi.

4.4 Aktive afatgjata materiale

- *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

- *Njohja dhe matja*

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

- *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

- *Amortizimi*

Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orëndi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse: është e mundur që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivit do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivët jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.6 Provigjonet

Një provigjon njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet janë përcaktuar duke lu zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

4.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

4.8 Fondet për pensione

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit, sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim përfitimi të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

4.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdoqofte rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohëshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

4.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.11 Angazhimet dhe kontigjencat

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.12 Garancitë financiare dhe angazhimet e huave

Garancitë financiare janë kontrata të cilat i lejojnë Institucionit të kryej pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin në rast humbjeje, kur një debitor nuk arrin të shlyejë huanë në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit. Angazhimet e huasë janë angazhime të cilat ofrojnë kredi me kushte dhe terma të paracaktuar.

Detyrimet që rrjedhin nga garancitë financiare apo angazhime për të siguruar një hua me normë interesi më të ulët se niveli i tregut maten me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë fillestare amortizohet përgjatë jetës së garancisë apo angazhimit. Detyrimi vlerësohet me vlerën më të lartë midis vlerës së amortizuar dhe vlerës aktuale të çdo pagese që pritjet të shlyhet në bazë të kontratës.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPi")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesit kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPi të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve të parashikuara të kredise

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

6. Aktive afatgjata materiale

Lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	Mobilje e pajisje zyre	Pajisje informatike	Asete në proces	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2018	1,901,743	332,241	488,111	2,722,095
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,901,743	332,241	488,111	2,722,095
Pakësime				
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,901,743	332,241	488,111	2,722,095
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2018	290,539	48,452	-	338,991
Amortizimi i vitit	322,241	70,947	-	393,188
Gjendja më 31 dhjetor 2018	612,780	119,399	-	732,179
Amortizimi i vitit	257,791	53,212	-	311,003
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	870,571	172,611	-	1,043,182
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,288,963	212,842	488,111	1,989,916
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,031,172	159,630	488,111	1,678,913

7. Aktive afatgjata Jomateriale

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2018	1,917,779	1,917,779
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,917,779	1,917,779
Shtesa	5,613,794	5,613,794
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	7,531,573	7,531,573
Amortizimi		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	1,917,779	1,917,779
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	7,531,573	7,531,573

8. Mjete monetare dhe ekuivalentet e saj

Balanca e mjeteve monetare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare EUR	29,088,384	10,999,830
Mjete monetare USD	438,595	-
Mjete monetare LEK	855,217	698,677
	30,382,196	11,698,507

9. Hua për klientët

Huatë për klientët më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua për Leasing	630,404,028	453,793,414
Klient për aktivitetin NPL	4,719,442	5,030,469
Klientë të tjere	2,403,615	8,551,732
Huadhënie afatshkurtër	44,307,810	22,673,488
Interesa të perlogaritura	1,761,301	1,229,144
Vlera bruto	683,596,196	491,278,247
Zbritje nga zhvlerësimi	(10,683,352)	(7,321,602)
Vlera bruto	672,912,844	483,956,645
Komisioni administrimi të paperfituara	(8,436,796)	(6,557,536)
	<u>664,476,048</u>	<u>477,399,109</u>

Lëvizja e zhvlerësimit të huave të dhëna

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Gjendja më 1 janar	7,321,602	5,522,936
Rimarrje për vitin	(1,190,393)	(1,788,132)
Zhvlerësimi për vitin	4,552,143	3,586,798
Gjendja më 31 dhjetor	<u>10,683,352</u>	<u>7,321,602</u>

10. Llogari të arkëtueshme nga tatimet

Balanca e llogarive të arkëtueshme nga tatimet më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH për tu rimbursuar	124,509,031	94,478,277
Tatimi mbi fitimin		30,000
	<u>124,509,031</u>	<u>94,508,277</u>

11. Llogari të arkëtueshme të tjera

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga të tretë (Shard Capital)	4,913,600	-
	<u>4,913,600</u>	<u>-</u>

12. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Balancat e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tollona karburanti	11,571	51,571
Parapagime të tjera	85,227	54,416
Paragime shërbimi përmbartimor	963,690	1,117,711
	<u>1,060,488</u>	<u>1,223,698</u>

13. Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 266,260,000 lekë dhe zotërohet nga aksionerët:

-Besnik Leskaj i cili zotëron 80% të aksioneve;

-Redjan Basha i cili zotëron 20% të aksioneve;

Fitim/(Humbjet) e mbartura për vitin 2019 janë në vlerën (10,974,335) lekë (2018: (15,075,769)).

14. Hua afatgjatë

Në këtë zë përfshihen huaja afatgjatë balanca e të cilës më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua afatgjatë Intesa San Paolo	245,338,785	120,684,665
Komision administrimi i huasë	(1,091,131)	(605,800)
	<u>244,247,654</u>	<u>120,078,865</u>

15. Hua afatshkurtër

Në këtë zë përfshihet pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë e marrë nga banka Intesa San Paolo balanca e të cilës më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Huamarrje Intesa San Paolo	116,738,769	57,499,772
	<u>116,738,769</u>	<u>57,499,772</u>

16. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë	3,749,172	7,054,553
Furnitorë për fatura të pambërritura	36,576	33,295
	<u>3,785,748</u>	<u>7,087,848</u>

17. Paradhënie të marra

Paradhënie të marra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paradhënie nga klientë	11,831,337	18,239,998
	<u>11,831,337</u>	<u>18,239,998</u>

18. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	244,102	204,897
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	283,700	280,450
Tatimi në burim	-	12,645
	<u>527,802</u>	<u>497,992</u>

19. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj personelit	24,311	24,186
Kreditorë të tjerë (Kontrata Shard NPL)	24,512,865	-
Kreditorë të tjerë	73,700	48,402
	<u>24,610,876</u>	<u>72,588</u>

20. Detyrime ndaj palëve të lidhura

Detyrimet ndaj palëve të lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua nga ortakët	157,083,145	129,684,210
Detyrime të tjera ndaj ortakëve	290,348	290,348
	<u>157,373,493</u>	<u>129,974,558</u>

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga qira financiare	42,839,673	28,650,910
Të ardhura nga interesa kredie	2,351,731	3,153,777
Të ardhura nga interesa faktoringu	243,377	1,021,200
Komisione administrimi qira financiare	3,919,062	2,208,273
Komisione sherbimi	2,711,855	2,114,800
Komisione nga faktoringu	87,789	847,519
Të ardhura nga kredia NPL	1,833,758	675,902
Të ardhura nga penalitete	1,485,491	931,954
	<u>55,472,736</u>	<u>39,604,335</u>

22. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga komisione si agjent	6,892,423	6,442,002
	<u>6,892,423</u>	<u>6,442,002</u>

23. Shpenzime për interesa

Shpenzimet për interesa për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për interesa	12,042,003	7,353,186
Penalitete	80,630	-
	<u>12,122,633</u>	<u>7,353,186</u>

24. Shpenzime për provizione

Shpenzimet për provizione për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Rimarrje provigjoni factoring	-	(740,000)
rovizione Kredia NPL	1,361,184	1,404,645
Rimarrje provigjoni kredia NPL	(1,003,209)	(19,436)
Provizione - Kontrata Leasing	2,593,938	1,026,798
Rimarrje provizioni leasing	-	(89,019)
Provsione hua te tjera	471,680	1,155,222
Rrimarrje provigjoni kredia	(54,674)	(939,677)
	<u>3,368,919</u>	<u>1,798,533</u>

25. Shpenzime për paga

Shpenzimet për paga për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	13,563,838	13,036,136
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,613,270	1,404,883
	<u>15,177,108</u>	<u>14,441,019</u>

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 shoqëria ka një numër mesatar prej 7 punonjësish. Struktura paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Staf menaxherial	3
Staf operacional	4
	<u>7</u>

26. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime amortizimi	311,003	393,188
	<u>311,003</u>	<u>393,188</u>

(Vlerat janë në Lekë)

27. Shpenzime nga veprimtaritë e tjera operative

Shpenzimet nga veprimtaritë e tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime qira	2,385,256	2,169,411
Shërbime ligjore dhe noteriale	1,680,467	48,600
Shërbime dhe konsulence nga palë të treta	1,703,163	1,333,490
Sponsorizime dhe donacione	613,150	
Mirëmbajtje dhe riparime	171,878	72,950
Shpenzime për karburant	299,120	183,071
Kancelari	100,866	179,431
Shpenzime telekomunikacioni	467,942	426,790
Shpenzime për shërbimet bankare	222,696	146,688
Shpenzime të tjera	507,544	412,920
Taksa dhe tarifa vendore	67,000	67,000
Gjoha dhe dëmshpërblime	2,500	14,970
	<u>8,221,582</u>	<u>5,055,321</u>

Në shërbime konsulence nga të tretë përfshihen shërbime auditimi dhe dhënie të tjera sigurie nga audituesi i pasqyrave financiare në shumën 337,843 lekë.

28. Fitim/(humbja) nga kurset e këmbimit

Fitim/(Humbja) nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime /(Të ardhura) nga këmbimet valutore	2,320,177	12,512,578
	<u>2,320,177</u>	<u>12,512,578</u>

29. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga interesat	-	(15)
Shpenzime komisioni	663,232	391,093
	<u>663,232</u>	<u>391,078</u>

(Vlerat janë në Lekë)

30. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	20,180,505	4,101,434
Total shpenzime të panjohura	59,444	155,547
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	-	155,547
Shpenzime të tjera	59,444	-
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	20,239,949	4,256,981
Humbje fiskale e mbartur	(10,492,786)	(14,749,767)
Fitim/humbja tatimore	9,747,163	(10,492,786)
Tatim fitimi @15%	1,462,074	-
	18,718,431	4,101,434

31. Palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Hua Blessed Investment	-	123,873,913	-	66,310,822
Arta Gurabardhi	-	-	-	18,012,532
Besnik Leskaj	-	18,753,850	-	37,077,425
Redjan Basha	-	8,373,333	-	8,283,449
Basha Retail&Distribution	11,337,871	-	7,081,391	-
Abkons	609,641	6,082,050	1,853,820	-
ARC	17,817,951	-	26,332,052	-
	29,765,463	157,083,146	35,267,263	129,684,228

Transaksionet me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
ARC	15,158,382	537,531	12,451,497	259,710
Abkons	1,686,458	2,185,082	858,301	1,909,700
Basha Retail&Distribution	1,663,941	-	2,360,052	-
	18,508,781	2,722,613	15,669,850	2,169,410

32. Manaxhimi i riskut financiar

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Institucionin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i tregut
- rreziku i normës së interesit
- rreziku i kreditit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i monedhës

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikëqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiarë të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Ndryshimet në normën e interesit ndikojnë:

- Përfitimën nga ndryshimi i të ardhurës neto nga Interesi dhe niveli i të ardhurave apo shpenzimeve të tjera që ndikohen nga Interesi;
- Vlerën ekonomike të aktiveve të Institucionit, detyrimeve dhe gjendjes jashtë bilancit, sepse vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare (dhe në disa raste edhe vetë flukset monetare) ndryshon kur ndryshojnë normat e interesit.

Instrumentat financiarë me interes fiks dhe variabël për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor	
	2019	2018
Instrumenta me interes fiks	2,085,927	2,598,777
Aktive Financiare	2,085,927	2,598,777
Detyrime Financiare	-	-
Instrumenta me interes variable	153,465,212	165,999,478
Aktive Financiare	672,625,911	473,868,125
Detyrime Financiare	(519,160,699)	(307,868,647)

32. Manaxhimi i riskut financiar**Risku i kreditit**

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për institucionin nëse klienti apo pala tjetër nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikësëpari prej llogarive të arkëtueshme nga Moneygram) dhe prej aktiviteteve të saj financiar, që përfshijnë kreditë dhe paradhëniet për klientët, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiarë.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Institucioni konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit (si rreziku që vjen nga vet klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Administrimi i rrezikut arrihet me:

- Formullimin e politikave të kreditimit, me kërkesat për mbulimin me kolateral, vlerësimin e kredive, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Themelimin dhe monitorimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e kredive. Bordi Drejtues i delegon autoritetin e tij për aprovimin e limiteve Komitetit të Kreditimit.
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditit. Drejtimi i Institucionit vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit.
- Rinovimet dhe rishikimet e kredive janë subjekt i politikës së kredive në fuqi.
- Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit të kundërpalëve. Institucioni strukturon nivelet e rrezikut të kreditimit që ndërmer duke vendosur limite mbi shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës ose një grup huamarrësish.
- Mbikëqyrja e ekspozimit aktual ndaj limiteve në mënyrë të shpeshtë. Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditit administrohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit për të përballuar shlyerjen e principalit dhe interesit, madje edhe duke i ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare(paperfshire paratë në dorë)	30,382,196	11,698,507
Investime në qera financiare neto	623,728,533	448,465,022
Hua dhe paradhënie te tjera	51,430,867	36,255,689
TVSH e arkëtueshme	124,509,031	94,478,277
Aktive të tjera	4,913,600	
Totali	<u>834,964,227</u>	<u>292,605,694</u>

32. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i kreditit (vazhdim)***Ekspozimi i huave dhe paradhenieve*

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Qira financiare neto		
1-30 dite Standarde	625,773,948	450,586,385
31-90 dite Në ndjekje	3,785,599	3,207,028
91-180 dite Nënstandarde	844,481	-
181-365 dite Të dyshimta		
>365 dite Të humbura		
	<u>630,404,028</u>	<u>453,793,413</u>

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua te tjera		
1-30 dite Standarde	44,307,811	22,673,488
31-90 dite Në ndjekje	225,495	-
91-180 dite Nënstandarde		330,249
181-365 dite Të dyshimta	4,493,947	4,700,221
>365 dite Të humbura		
	<u>49,027,253</u>	<u>27,703,958</u>

Portofoli leasing sipas llojit të financimit:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Pajisje dhe makineri		
Prona të paluajtshme	31,728,710	10,696,220
Mjete transporti	596,516,027	441,831,480
Te tjera	2,159,291	1,265,712
	<u>630,404,028</u>	<u>453,793,412</u>

Albanian Financial Institution sh.p.k
 Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

33. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i kreditit (vazhdim)

Risku i kreditit sipas sektorëve financiarë paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Qira financiare	Hua te tjera	Qira financiare	Hua te tjera
Bujqësia, gjuetia, silvikultura	883,816.00	-	-	-
Industria nxjerrëse	7,573,597.18	-	10,222,632	-
Industria përpunuese	51,340,482.31	-	66,508,613	-
Ndërtim	166,304,471.42	-	101,264,697	-
Hotele dhe restorante	9,419,170.09	-	13,185,982	-
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	17,004,967.40	-	1,427,642	-
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake	60,188,123.82	37,219,311.06	49,884,129	22,673,488
Arsimi	-	-	-	-
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	7,664,760.29	-	8,494,485	-
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale	291,495,682.39	-	187,529,252	-
Te tjera	18,528,956.70	11,807,942.01	15,275,981	5,030,469
	630,404,027	49,027,253.07	453,793,413	27,703,957

Albanian Financial Institution sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lekë)

32. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të biera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do t'i duhet të ketë shumën të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilin e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Tabela e mëposhtme paraqet aktivitet dhe detyrimet sipas maturitetit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, bazuar në flukset hyrëse/dalëse të të parësë të institucionit duke reflektuar cdo supozim rripagese të hershme ose mbajtje:

Përshkrimi	31 dhjetor 2019				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	8,996,446	47,429,980	627,169,770	-	683,596,196
Mjete monetare në arkë dhe bankë	30,382,196	-	-	-	30,382,196
Totali	39,378,642	47,429,980	627,169,770	-	713,978,392
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(5,745,624)	(24,610,876)	-	-	(30,356,500)
Hua	-	(116,738,769)	(407,421,930)	-	(519,160,699)
Totali	(5,745,624)	(141,349,645)	(407,421,930)	-	(549,517,199)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	33,633,018	(93,919,665)	224,747,840	-	164,461,193

Përshkrimi	31 dhjetor 2018				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	8,551,732	22,752,759	459,973,756	-	491,278,247
Mjete monetare në arkë dhe bankë	11,698,507	-	-	-	11,698,507
Totali	20,250,239	22,752,759	459,973,756	-	502,976,754
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(7,658,428)	-	-	-	(7,658,428)
Hua	-	(57,499,772)	(250,053,423)	-	(307,553,195)
Totali	(7,658,428)	(57,499,772)	(250,053,423)	-	(315,211,623)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	12,591,811	(34,747,013)	209,920,333	-	187,765,131

Albanian Financial Institution sh.p.k
 Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

32. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës

Institucioni është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës përmes transaksioneve në monedhë të huaj. Meqë monedha e përdorur nga institucioni në paraqitjen e pasqyrave financiare është Lek, pasqyrat financiare të Institucioni ndikohen nga luhatjet në kursët e këmbimit midis Lek-ut dhe monedhave të tjera.

Institucioni është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes pozicioneve të hapura valutore. Pozicioni i hapur valutator neto në një monedhë të caktuar është shuma, ekuivalente në Lek e diferencës ndërmjet totalit të aktiveve dhe totalit të detyrimeve të Institucionit në atë monedhë.

Institucioni është i detyruar të respektojë limitet e Pozicionit të Hapur Neto Forex dhe të Pozicionit të Hapur Total. Neto Forex të vendosura nga Banka e Shqipërisë.

Analiza e pozicionit monetar më 31 dhjetor 2019 sipas monedhave në të cilat paraqiten është si më poshtë:

Përshkrimi	31 dhjetor 2019			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	676,634,368	6,961,828	-	683,596,196
Mjete monetare në arkë dhe bankë	29,088,384	855,217	438,595	30,382,196
Totali	705,722,752	7,817,045	438,595	713,978,392
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(22,231,005)	(8,125,495)	-	(30,356,500)
Hua	(519,160,699)	-	-	(519,160,699)
Totali	(541,391,704)	(8,125,495)	-	(549,517,199)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2019	164,331,048	(308,450)	438,595	164,461,193

Përshkrimi	31 dhjetor 2018			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	484,921,451	6,356,796	-	491,278,247
Mjete monetare në arkë dhe bankë	10,999,829	698,678	-	11,698,507
Totali	495,921,280	7,055,474	-	502,976,754
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(7,054,554)	(603,874)	-	(7,658,428)
Hua	(307,553,195)	-	-	(307,553,195)
Totali	(314,607,749)	(603,874)	-	(315,211,623)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018	181,313,531	6,451,600	-	187,765,131

33. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

34. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vlijmësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 5 "vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë te pasqyrat financiare.

 **CONTACT**

Mazars Shpk

Tirana, Albania
Tel. +355 4 2222 889
Tel. +355 4 2278 015
info@mazars.al

Pristina, Kosovo
Tel. +381 38 609 029
infosovo@mazars.al

www.mazars.al